



# BE-JA DHE MAQEDONIA E VERIUT

#WesternBalkans  
#EUEnlargement

Tetor 2024



Maqedonia e Veriut është **shtet kandidat për në BE** që nga viti 2005



## Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor

Në vitin 2023, BE shpalli një **Plan historik të Rritjes** për të përshpejtuar zhvillimin socio-ekonomik të partnerëve të Ballkanit Perëndimor dhe integrimin në BE.

Plani **synon të nxisë konvergencën socio-ekonomike** përmes **integritit të zgjeruar ekonomik me tregun e vetëm të BE-së**, integritit rajonal **brenda tregut të përbashkët rajonal**, duke përshpejtuar reformat themelore.

Si pjesë e këtij Plani të Rritjes, Maqedonia e Veriut u ftua të përgatisë një **Agjendë Reformuese** që fokusohet në reforma për të **zhbllokuar potencialin e rritjes kombëtare dhe rajonale** dhe reforma që kanë të bëjnë me bazat e procesit të zgjerimit, **duke përfshirë sundimin e ligjit, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore.**

**Programi i Mbështetjes për reforma dhe rritje** prej 6 mld euro për Ballkanin Perëndimor do të do të ofrojë mbështetje kyçe për zbatimin e Planit të Rritjes. Komisioni miratoi Agjendën e Reformës së Maqedonisë së Veriut në tetor 2024. **750.4 milionë euro grante të pakthyeshme dhe kredi të favorshme** do të jenë në dispozicion të Maqedonisë së Veriut kur të përmbushë kushtet për të cilat është zotuar në Agjendën e saj të Reformës.



**BE-ja është i  
Maqedonisë  
së Veriut**

✓ partneri më  
i madh tregtar

✓ investori më  
i madh

✓ ofruesi më i madh  
i ndihmës financiare



## Mbështetja e vazhdueshme e BE-së për Maqedoninë e Veriut

BE-ja është **ofruesi më i madh i ndihmës financiare** për Maqedoninë e Veriut. Ajo ofron një sërë programesh dhe instrumentesh për të mbështetur zhvillimin e Maqedonisë së Veriut dhe procesin e anëtarësimit në BE.

### Instrumenti i Para - Aderimit (IPA)

Në **2021-2024**, BE-ja ka ndarë **mbi 300 milionë euro** ndihmë financiare dhe teknike për Maqedoninë e Veriut në kuadër të IPA III. Ndihma ofrohet në formën e **granteve të pakthyeshme**. Kjo përfshin:

- **€80 milionë Pakoja për Mbështetje Energjetike**, e cila ka mbështetur familjet e rrezikuara dhe kompanitë e vogla dhe të mesme në Maqedoninë e Veriut në ballafaqimin me rritjen e çmimit të energjisë.
- **€18 milion** për të rritur **efektivitetin dhe efikasitetin e administratës publike** në Maqedoninë e Veriut.
- **Mbi 20 milionë euro për të përshpejtuar reformën dhe transformimin e mjedisit të biznesit** në rrugën e Maqedonisë së Veriut për t'iu bashkuar Tregut të Vetëm, duke u mbështetur në sinergjitë ndërmjet inovacionit, bujqësisë, tranzicionit energjetik dhe zhvillimeve të sektorit privat.

### Plani Ekonomik dhe i Investimit (EIP)

EIP-i i BE-së për Ballkanin Perëndimor identifikon 10 investime kryesore në transportin e qëndrueshëm, energjinë e pastër, mjedisin dhe klimën, të ardhmen digjitale, kapitalin njerëzor dhe sektorin privat, për të mbështetur një **tranzicion të gjelbër dhe digjital** dhe për ta sjellë rajonin **më afër tregut të vetëm të BE-së**.

Për projektet në **Maqedoninë e Veriut**, që nga viti 2020 BE ja tashmë ka mobilizuar **1.7 miliardë euro investime falë 594 milionë euro grante të BE-së**. Fondet mbliidhen përmes mjeteve të tilla si Korniza e Lehtësimit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF). Kjo përfshin:

- Rehabilitimi i një **linje hekurudhore prej 34 km** ndërmjet Beljakovcës dhe Kriva Pallankës në Korridorin VIII hekurudhor, e cila duhet të sigurojë qasje të drejtpërdrejtë në mjetet moderne të transportit **për më shumë se 350 000 njerëz**.
- Rritja e kapacitetit të parkut me erë të Bogdancit deri në 15 MW, gjë që do të mundësonte **furnizimin e 22 000 familje me energji të pastër** dhe të shmangë 153 600 tonë emetim CO2 çdo vit.
- Ndërtimi i një **impianti për trajtimin e ujërave të zeza** për Shkupin, që pritet të shërbejë 528 900 banorë dhe të zbusë ndotjen e lumit Vardar.



### Çfarë jemi duke arritur së bashku



**957 MW** kapaciteti prodhimit të energjisë së rinovueshme të instaluar



**107 km** e tubacioneve të gazit të ndërtuara për të ardhmen



**205 km** të linjave hekurudhore të rehabilituara




Shërbime efikase të mbetjeve të ngurta për **1.4 milionë njerëz**



## Lidhjet e afërta tregtare dhe investuese

**BE-ja është partneri kryesor tregtar i Maqedonisë së Veriut.** Në vitin 2023, BE-ja përbënte 60.4% të tregtisë totale të mallrave të Maqedonisë së Veriut (77.3% të totalit të eksporteve dhe 47.7% të importeve totale). Totali i Investimeve të Huaja Direkte të BE-së arriti në 519.6 milionë euro në vitin 2022\*.

Liberalizimi progresiv i tregtisë dhe qasja e ndërsjellë pa doganë për shumicën e mallrave ka ndodhur që nga viti 2004 dhe aktualisht bazohet në **Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit** BE-Maqedonia e Veriut (MSA).



© Zoltan Vasadi, Mustafa Comor and Jasmin Zeherovic



## Bashkëpunimi në politikën e jashtme dhe të sigurisë

Maqedonia e Veriut ka vazhduar të përafrohet plotësisht me qëndrimet dhe deklaratat e **Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes** të BE-së. Përveç kësaj:

- Maqedonia e Veriut ka vazhduar të marrë pjesë aktive në misionet dhe operacionet e BE-së për menaxhimin e krizave në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes.
- Maqedonia e Veriut përfitoi nga ndihma e dytë dypalëshe masë në kuadër të **Fondit Evropian të Paqes** në 2024.
- Task Forca Mjekësore e Ballkanit, në të cilën merr pjesë Maqedonia e Veriut, përfiton nga një mbështetje prej 6 milionë eurosh për vitin 2022 në kuadër të **Fondit Evropian të Paqes**.
- BE-ja ofron mbështetje për përbashkëtimin e kërcënimeve hibride, duke përfshirë manipulimin dhe ndërhyrjen e informacionit kibernetik dhe të huaj.



## Kontaktet mes popujve

- Që nga viti 2010, qytetarët nga Maqedonia e Veriut përfitojnë nga **udhëtimi pa viza** në BE.
- BE-ja ka financuar mbi **34 500 shkëmbime** ndërmjet qytetarëve të BE-së dhe Maqedonisë në fushat e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit nën **ERASMUS+** (2014-2020).
- Qytetit të **Shkupit** iu dha titulli **Kryeqytet i Kulturës Evropiane 2028**.

\* Source: DG Trade

[ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement)  
[facebook.com/EUnear](https://facebook.com/EUnear) | [x.com/eu\\_near](https://x.com/eu_near)

© European Union, 2024

Reuse of this document is allowed, provided appropriate credit is given and any changes are indicated (Creative Commons Attribution 4.0 International license). For any use or reproduction of elements that are not owned by the EU, permission may need to be sought directly from the respective right holders. All images © European Union, © Adobe Stock and © Shutterstock, unless otherwise stated.